



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:227702
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06771046

Rev.nr.421/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Zenel Leku dhe Muhamet Rexha, anëtar, në çështjen juridike të paditësit D. Th. nga fshati B., Komuna S., të cilin e përfaqëson me autorizim Fatbardh Makolli avokat nga Prishtina, kundër të paditurës “T.-M.” Sh.P.K. Z. I. në P., të cilin e përfaqëson me autorizim Naim Haliti avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 25,631.00€, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.9217/2021, të datës 05.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET i pathemeltë revizioni i paditësit D. Th. nga fshati B., Komuna S., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.9217/2021, të datës 05.07.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj C.nr.350/2017, të datës 23.03.2021, është “Aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit D. Th. nga fshati B., Komuna S., e ushtruar ndaj të paditurës “T.-M.” Sh.P.K. Z. I. në P. dhe detyrohet e paditura që paditësit t’i kompenzoj demin të cilin e ka pësuar me datë 23.12.2016, në Pejë në Rr “Mehmet Akifi Peja”, gjatë kryerjes së detyrave të punës të Elektricitetit në sanim të një defektit në shtyllë elektrike dhe nga pakujdesia e drejtuesit të automjetit M. M., i cili nuk i ka vendosur pykat rrotëve që të mos lëviz automjeti, në atë moment kur paditësi kërkon uljen nga shporta e lëviz automjeti mbrapa afërsisht dy (2) metra dhe paditësi kur e ka vërejtë rrezikun ka dal nga shporta është kapur për një teli të rrymës të mbuluar, i cili është këputë dhe ka rënë në tokë nga një lartësi prej gjashtë (6) metra, duke pësuar lëndime të rënda trupore dhe për këtë t’i kompenzoj demin në shumat si në vijim: Dëmi jo material: Për dhimbjet fizike shumë prej 4000 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 3500 euro, për shëmtim trupor të shkallës së mesme shumë prej 3000 euro, për zvogëlim të aktivitetin jetësor prej 23.5% shumë prej 12,000 euro. Dëmi material, për ndihmën e personit të tretë shumë prej 300 euro, për ushqimin e përforcuar shumë

prej 840 euro, për rehabilitim klimatik shumë prej 500 euro, për fitimin e humbur për zvogëlim të aftësisë punuese nga data 23.12.2016, deri me datë 31.01.2021 shumë prej 4,491 euro, si dhe rentën mujore në shumë prej 89 euro në muaj, e cila duhet të paguhet për çdo muaj në vijim më së largu deri me datë pesë (5), deri me datë 21.06.2021 kur paditësi del në pension. Gjithsejtë në shumë 28,631 euro (njëzet e tetëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e një euro) që obligohet t'ë paguaj të zbritur në shkallën prej 30 %, për shkak të përgjegjësisë të ndarë ngase paditësi duke mos i zbatuar masat mbrojtëse në punë ka dhënë kontribut sekondarë në shkaktim të dëmit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 3,159 euro, të gjitha në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes së aktgjykimit, me kamatën ligjore në normën prej 8% nga dita e gjykimit nën kërcenim të përmbarrimit. Refuzohet si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë për dhimbje fizike shuma prej 6,000 euro, për frikën e përjetuar shuma prej 5,500 euro, për shëmtim trupor shuma prej 3,000 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shuma prej 13,000 për ndihmën e huaj shuma prej 1,700 euro, për ushqimin e përforcuar shuma prej 1,160 euro dhe për rehabilitim klimatik 3,500 euro”.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse, me aktgjykimin Ac.nr.9217/2021, të datës 05.07.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të refuzoj të pabazuar ankesën e paditësit D. Th. nga fshati B., Komuna S. dhe ankesën e të paditurës “T.-M.” Sh.P.K. Z. I. në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj C.nr.350/2017, i datës 23.03.2021, vërtetohet. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që pjesa e dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, mbetet e pa shqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, brenda afatit ligjor, revizion ka paraqitur paditësi përmes të autorizuarit të tij, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranojë revizionin dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj, duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e precizuar të paditësit si të bazuar.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi më datë 13.11.2017, përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material, më konkretisht me arsye sikurse në padi, ndërsa më datë 22.02.2021, e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ku ka kërkuar nga e paditura që ti kompensohen në emër të dëmit material dhe jo material shumat e cekura si në precizim të kërkesëpadisë, përfshirë këtu edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.350/2017, të datës 23.03.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pasi që në mes të palëve ndërgjyqjese edhe më tutje mbetet kontestuese baza juridike e kërkesë padisë, në propozimin e palës paditëse është nxjerrë prova e Sigurisë në punë nga eksperti Dr. Ing. H. N., i cili me mendimin dhe konstatimin e dhënë me shkrim me datë 05.12.2019 dhe me sqarimet e dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 23.12.2019, ka ardhur në përfundim se pas analizimit të gjitha rrethanave dhe faktorëve ku ka ndodhë aksidenti në punë, rrjedhë se punëdhënësi në kuadrin e përgjegjësive ka qenë i detyruar të marrë masa për sigurinë dhe shëndetin në punë që përfshin masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, dhe dhënia e udhëzimeve të duhura për punë të sigurt. Punëdhënësi gjithashtu ka qenë i detyruar të zbatoj masat parandaluese bazuar në parimet e përgjithshme të parandalimit të rreziqeve në punë, andaj bartë përgjegjësi primare. Padiësi mban përgjegjësi sekondare në shkaktim të aksidentit në punë për arsye se nuk i ka zbatuar detyrimet e përcaktuara me Ligjin nr. 04 –L 161 duke mos u kujdesur për sigurinë dhe shëndetin në punë sepse nuk ka përdorur rripin e sigurisë. Gjukata e ka vlerësuar ekspertizën e dhënë nga eksperti gjyqësor për sigurinë në punë dhe të njëjtës i ka dhënë bindje të plotë si provë e besueshme dhe vendimtare mbi bazën e së cilës është konstatuar se e paditura është përgjegjëse primare në shkaktim të aksidentit në punë dhe mban përgjegjësi në shkallën prej 70%, ndërsa i padituri ka dhënë kontribut sekondar në shkaktim të aksidentit në shkallën prej 30%, sipas konstatimeve të ekspertit. E paditura mbanë përgjegjësi primare për kompenzim të demit ngase i punësuari i saj është shkaktari primar i demit dhe për këtë gjykata bazohet në dispozitat e nenit 152 par. 1 i LMD-së.

Naturën e lëndimeve të padiësit, gjykata e shkallës së parë e ka konstatuar nga ekspertiza ekspertëve mjeko-ligjor nga lëmi i ortopedisë Dr. Xh. S. – ortoped –traumatolog dhe Dr. V. A.-S. psikiatër. Ekspertët e lartcekur kanë ardhur në përfundim në bazë të dokumentacionit mjekësor, raportit të emergjencës, raporteve specialistike dhe ekzaminimit të padiësve se padiësit si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe atë: thyerje qendrore e filgjanit të kërdhokullës së djathtë, thyerje e krahut të sipërm dhe të poshtëm të kockës së turpit- majtas, thyerje serike e brinjëve III- 6 të anës së majtë të krahavorit, zhvendosje e nyjës së krahut të djathtë. Këtë ekspertizë gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar si profesionale, më të dhënat të mjaftueshme dhe të besueshme për të caktuar lartësinë e kërkesëpadisë, andaj të njëjtës i ka dhënë besimin. Më tej gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se për të vërtetuar bazën juridike të padisë në faktin se e paditura është përgjegjëse për dëmin të cilës padiësit i kanë shkaktuar gjatë kryerjes së detyrave të punës, gjykata e detyroj të paditurën që padiësit ti paguajnë në emër të dëmit material dhe jo material shumë si në pikën pjesën aprovuese të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Me rastin e përcaktimit të lartësisë së dëmit gjykata pati në konsiderim të gjitha rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e tij, andaj, në bazë të këtyre pasojave sipas ekspertit padiësi ka pasur dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme që kanë zgjatur dhe zgjasin për periudha të caktuara kohore. Gjithashtu i ka gjykuar kërkesat tjera të padiësit lidhur me dëmin material pasi që eksperti mjekësor konstatoj se tek padiësi ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 23.05 %, për shkak të kufizimit të lehtë të lëvizjeve në krahun e djathtë 5 % - P.1.2.2 a (dora dominante), thyerjes së 3 brinjëve me vendosje në anën e majtë të krahavorit – 10 % -P.5.1.2 dhe kufizim të lëvizjes së kërdhokullës së djathtë në shkallë të lehtë me artroz 10 % - P.2.2.3 e krahut III të tabelës mbi ZAJ dhe e njësuar sipas formulës së Baltfazarit. Gjukata për këtë shkallë të zvogëlimit të aktivitetit jetësor i ka aprovuar shumë prej 12,000 euro, duke marrë për bazë faktet se padiësi gjatë gjithë jetës do të përjetoj dhimbje

shpirtërore sa herë që e ndjen këto kufizime të aktivitetit jetësor në raport me gjendjen shëndetësore para se të lëndohej. Tek paditësi ka mbetur shëmtimi trupor mesatar për shkak të vrazës operatore në gjatësi prej 19 cm në kërdhokullën e djathtë dhe për këtë, gjykata ka aprovuar shumën prej 3,000 euro për dhimbjet shpirtërore që i përjeton sa herë kjo vrazë mund të shifet gjatë pushimeve në detë apo në ndonjë qendër rehabilituese, në rastin konkret si kriter vlerësues është marrë edhe mosha e paditësit. Duke vlerësuar se janë përmbushur kërkesat ligjore nga nenet 183 të LMD-së, si dhe nenit 323 të LPK-së e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Vendimin për shpenzimet në bazë të nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesave të palës ndërgjyqëse, me aktgjykimin Ac.nr.9217/2021, të datës 05.07.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të refuzoj të pabazuar ankesën e paditësit D. Th. nga fshati B., Komuna S. dhe ankesën e të paditurës "T.-M." Sh.P.K. Z. I. në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj C.nr.350/2017, të datës 23.03.2021, vërtetohet. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që pjesa e dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, mbetet e pa shqyrtuar.

Gjykata e Apelit në pjesën arsyetuese ka theksuar se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfshirë në shkelje esenciale të ligjit të procedurës kontestimore, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar. Më tej në arsyetim të aktgjykimin ka theksuar se me rastin e vendosjes vlerësoi pretendimet e përfaqësuesit të paditësit të paraqitura me ankesë se shumtë e gjykuara, si për dëmin jo material ashtu edhe për dëmin material, nuk janë në harmoni me lëndimet që paditësi i ka pësuar në aksidentin lëndor. Këto pretendime të përfaqësuesit të paditësit nga kjo gjykatë vlerësohen si të pabazuara sepse fillimisht nga paditësi nuk është atakuar asnjëra nga kategoritë e shumave të gjykuara, më specifikisht, qoftë të dëmit jo material apo material, por vetëm është goditur aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në përgjithësi. Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas pretendimeve të përgjithësuara të ankesës, vlerësoi secilën shumë të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në këtë rast dhe erdh në përfundim ashtu siç u vlerësuar më lart, se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar drejtë lartësinë e kategorive të dëmit, që ju ka shkaktuar paditësit në aksidentin lëndor, në raport me ndarjen e përgjegjësisë 70%, për të paditurën dhe 30%, për paditësin. Gjykata e Apelit, vlerësoi edhe pretendimin e përfaqësuesit të paditësit se kompensimi i dëmit nuk është real, bazuar edhe në praktikën e gjykatave të Kosovës, në raport me lëndimet, që i ka pësuar paditësi. Mirëpo edhe ky pretendim i paditësit është i pabazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë, drejtë e ka vlerësuar dhe zbatuar të drejtën materiale, pasi që fillimisht në bazë të ekspertizës lidhur me shkaqet e punëtorit në punë – në këtë rast paditësit, e punuar nga ekspert Dr. H. N. e datës 07.12.2019 dhe sqarimet e dhëna nga i njëjti në seancën e datës 23.12.2019, për siguri dhe mbrojtje në punë, është konstatuar përgjegjësia primare e të paditurës si punëdhënëse dhe përgjegjësia sekondare e paditësit si punëmarrës në aksidentin, në vendin ku ishte duke punuar. Prandaj gjykata e shkallës së parë me drejtë e ka vlerësuar dhe gjykuar çështjen lëndore që për 70%, të përgjegjësisë është e paditura, pasi që: nuk i ka ndërmarr masat për parandalimin e rreziqeve profesionale dhe dhënien e udhëzimeve të duhura për punë të sigurt. Pasi e paditura si punëdhënëse ka qenë e detyruar të zbatoi masat parandaluese, bazuar në parimet e përgjithshme të parandalimit që në këtë rast nuk janë ndërmarr nga e paditura, andaj mban përgjegjësi primare, për lëndimin e paditësit bazuar edhe në detyrimet nga neni 6, neni 7 dhe

nenit 13 e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe nenet 3,4,5 dhe 42 i Ligjit të Punës. Ndërsa për paditësin është gjykuar çështja lëndore nga gjykata e shkallës së parë më të drejtë për 30%, të përgjegjësishë sepse paditësi ish dashtë që të ketë më shumë kujdes e sidomos si shkak i përvojës së tij, në kësi lloj detyrash në punë e që është dashtë ta vendos rripin e sigurisë dhe helmetën, si dhe të sigurohet paraprakisht për fiksimin apo pa mundësinë e lëvizjes së kamionetës respektivisht shportës ku ishte paditësi, të gjitha këto lëshime të paditësit kanë ndikuar edhe në rritjen e dëmit në rastin lëndor, prandaj të gjitha këto lëshime si të paditurës ashtu edhe të paditësit, janë në kundërshtim me Ligjin për Siguri dhe Shëndetin në Punë. Për shumat e gjykuara për kompensim të dëmit në të gjitha kategoritë e dëmit, nga gjykata e shkallës së parë, në raport me 70% me 30%, të përgjegjësishë së ndërgjyqësve, janë të shumta në harmoni më praktikën e krijuar nga gjykata në nivel vendi, në harmoni me lëndimet e pësuara nga paditësi në vendin e tij të punës dhe janë në harmoni më Udhëzuesin për caktimin e Kritereve Orientuese dhe Lartësisë së Shpërblimit të Drejtë në të Holla të Dëmit jo Material i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallë së dytë, pasi ka vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në përputhje me gjendjen faktike të provuar, duke lënë në fuqi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, me të cilat është detyruar e paditura që paditësit t'ia kompensoj shumat e gjykuara sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Sa i përket bazës juridike, përkatësisht përgjegjësishë së të paditurës në bazë të përgjegjësishë, e cila gjen mbështetje në nenin 136 dhe 140 Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit (LMD), të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë e që është pranuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë, Gjykata Supreme pranon qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta dhe arsyet që janë dhënë sa i përket bazës juridike për detyrimin e të paditurës për kompensimin e dëmit paditësit. Shtu këtu edhe faktin se në rastin konkret revizion ka parashtruar vetëm pala paditëse e jo pala e paditur.

Gjykata Supreme ka refuzuar revizionin e palës paditëse dhe kërkesën e saj për ndryshimin e aktgjykimeve të instancave më të ulëta dhe aprovimin në tërësi të kërkesëpadisë së precizuar, pasi në revizion ka pasur pretendim se shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material për paditësin janë shumë të ulëta. Kjo për faktin se ka rezultuar se të njëjtat pretendime janë të pa bazuara, pasi aplikimi i dispozitave materialo-juridike, të cilave iu është referuar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, përkatësisht dispozitat e nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) është në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë konstatimet profesionale të ekspertëve mjekësor mbi natyrën e lëndimeve, llojin dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, llojin, intensitetin, kohëzgjatjen dhe mënyrën e manifestimit të frikës, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 23.5 % dhe të shëmtimit në shkallë të mesme, si dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, siç janë mosha e paditësit dhe praktika gjyqësore për raste të tilla. Si rezultat i kësaj, kjo gjykatë vlerëson se shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës

së parë, e të vërtetuara nga gjykata e shkallës së dytë në emër të dëmit jo material janë shuma që i përgjigjen qëllimit të kompensimit të dëmit në rastin konkret. Nga arsyet që janë dhënë në lidhje me shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material, rezulton se gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë e ka pasur në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t'i përputhet qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin.

Përveç kësaj, është vlerësim i Gjykatës Supreme se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësin, dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla. Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet e revizionit të paditësit, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykatat e instancës më të ulët kanë vendosur në përputhje me gjendjen faktike dhe se shumat e gjykuara i përgjigjen natyrës së lëndimit dhe pasojave që ka pasur paditësi si rezultat e lëndimit në aksidentin e ndodhur në punë me datë 23.12.2016, si dhe janë në përputhje me dispozitat materiale, përkatësisht nenin 183 të LMD-së. Në lidhje me këtë, është i drejtë edhe qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët, se bazuar në ekspertizën e sigurisë në punë, shumat e gjykuara për kompensim të dëmit në të gjitha kategoritë e dëmit, është bërë duke marrë për bazë edhe kontributin e paditësin në shkaktimin e aksidentit në punë, e që nga ekspertiza përkatëse ky kontribut është vlerësuar në shkallë prej 30%.

Në anën tjetër, vlerësohen të pabazuara pretendimet e revizionit të paditësit, edhe pse të njëjtat nuk janë specifike, por të përgjithësuara në kuptim të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, lidhur me lartësinë e gjykuar për paditësin në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar, shërimit për terapi fizikale dhe ndihmë të personit të huaj. Në lidhje me këtë, rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta, drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e vendosjes së këtyre kategorive të dëmit material, pasi që është provuar fakti nga ekspertizat mjekësore, ku është konstatuar periudha dhe nevoja për ushqim të përforcuar, si dhe ndihmë të personit të tretë, e cila është gjykuar edhe në përputhje me praktikën gjyqësore. Gjithashtu edhe shuma e gjykuar në emër të dëmit material për rehabilitim klimaterik është gjykuar në bazë të provave materiale (faturat) të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në përputhje me nenin 179 të LMD-së.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222 të LPK, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Rev.nr.421/2024, datë 27.01.2024

Kryetari i Kolegjit- Gjyqtari

Lumni Sallauka